



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:167256

Datë: 21.12.2023

Numri i dokumentit: 05105046

C.nr.4575/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.A, nga Prishtina, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.K, , avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës – Drejtoria e Personelit, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensim i pagës së trembëdhjetë, lartësia e objektit të kërkesës 1,251.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 21.12.2023, jep këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.A, , ashtu që detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës – Drejtoria e Personelit, që në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, dhe 2020, t’ia paguaj për çdo vit shumën nga 417.00 €, apo në total, shumën prej 1,251.00 €, me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë datë 04.08.2023, e gjer në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETRYOHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës – Drejtoria e Personelit, që paditësit F.A, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 125.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, me datë 04.08.2023, ka paraqitur padi, të cilën e ka precizuar me datën 02.11.2023, kundër të paditurës lidhur me pagesën e pagave të fund vitit për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën Policinë e Kosovës, që nga data 11 Korrik 2015, në pozitën Radiokomunikues dhe baza e të dhënave në Drejtorinë e Departamenteve për Operacione në Prishtinë. Tutje ka shtuar se duke e patur parasysh se paditësi për vitet 2018, 2019 dhe 2020, si personel i policisë ka marrë vlerësim të knaqshëm nga eprorët e tij dhe se nuk ka qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda viteve përkatëse, ka ushtruar kërkesë tek e paditura për pagesën e pagave të fundit vitit për

vitet në fjalë, por që është refuzuar. Andaj, nga këto arsye ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të pagës së fundvitit t'ia paguaj shumën prej nga 417.00 Euro për vitet 2018, 2019, si dhe 2020, apo në total shumën prej 1,251.00 Euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive të detyrimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për padi shumën prej 104.00 euro, për taksën për padi shumën prej 21.00 euro, si dhe për parashtrësën për plotësimin e padisë shumën prej 104.00 euro, apo në total shumën prej 229.00 euro.

E paditura me datë 18.12.2023, ka parashtruar përgjigje në padinë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se pagesa në emër të kompensimit të pagës së fund vitit dhe shujtës ditore nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak mungesës së mjeteve financiare, përveç shpërbllimit jubilar të cilin e ka përmbushur për të gjithë punonjësit duke përfshirë edhe paditësin. Tutje ka theksuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së fund vitit dhe shujtave ditore. Në fund ka theksuar se kërkesëpadinë e paditësit e kundërshton pasi që kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj, e njëjta nuk mund të jetë obligim dhe detyrim i të paditurës, duke theksuar se e paditura ndaj paditësit të vetmin detyrim ligjor e ka përmbushjen e Kontratës së Punës, e cila konsiderohet ligj për palët. Nga këto arsye ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditësit është e bazuar për arsye se:

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri me datën 07.06.2023, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit me nr.reference 07/1-01SAP-P/12841, dt.31.10.2023, i cili iu është bashkangjitur shkresave të lëndës.

Nga vërtetimi i punësimit të cekur më lartë gjykata konstatoi se paditësi e ka filluar punën te e paditura nga data 11.07.2005 e deri me datën 07.06.2023, kur e ka arritur moshën e pensionimit.

Kurse nga historiat i llogarisë bankare të lëshuar nga Banka Ekonomike Sh.a., me seli në Prishtinë, me datat 31.10.2023 në emër të paditësit F.A., , rezulton se i njëjti kishte realizuar pagë mesatare mujore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, në shumën prej 417.00€.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesën e aprovuara të paditësit, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13, për vitet 2018, 2019, dhe 2020.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.*

Nga interpretimi i dispozitës të lart cituar të Udhëzimit Administrative 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të nxjerr nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitoj si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësi, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi, ka vlerësim të mirë të performancës dhe në këta formualr nuk ka ndonjë konstatim se të njëjtit iu është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, për gjatë viteve 2018, 2019, dhe 2020. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, dhe 2020, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit dhe pasqyrën e llogarisë së paditësit, të vlerësuar si më lart, nga e cila rezulton paga të cilën e realizon paditësi, andaj të njëjtit për vitet 2018, 2019, dhe 2020, i takon shuma ashtu siç është vendosur në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që t'ia kompensoj paditësit, pagat e 13-ta, për fund vitet 2018, 2019, dhe 2020. Andaj paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar ne nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shumën e gjykuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 04.08.2023, dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ, se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimi Administrativ i lartcekur, është aprovuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuar, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç ka kërkuar paditësi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzime e procedurës, gjykata e ka bazuar në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet në shumë prej 125.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 104.00 € dhe në emër të taksës për padi shumën prej 21.00€. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet për parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë në shumën prej 104.00 Euro, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.4575/23, datë 21.12.2023

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.